



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioneri Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 34

Datë: 04. 08. 2020. Ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Sami Kurteshi, Alim Rama, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Nenad Rikalo, Rifat Krasniq, Arianit Elshani, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši.

SKQZ: Ylli Buleshkaj, u.d. i Kryeshefit

Përkthyese: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;
Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 30 dhe 31/2020.

2. Mungesa e rojeve të polisë së Kosovës në Qendren e Numërimit të KQZ-së

3. Raporti i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Cështje Ligjore:

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Prishtinë, Kaçanik, Junik dhe Podujevë.

3. Të ndryshme.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

Valdete Daka: Mirë se keni ardhur në këtë mbledhje të 34-t. Nuk kemi incizim të mbledhjes, por a dikush diçka për të shtuar ?

Sami Kurteshi: Dy çështje që i kam ngritë përmes komunikimit elektronik: kam propozuar pika të caktuara që besoj e dini, por nuk janë në agjendë asnjëra...! E këto janë: çështja e zëvendëskryeshefit të SKQZ-së, dhe qëndrimi i policisë së Kosovës që të mos e ruaj më tej QNR-në. Nëse duhet, i arsyetoj këto pika por, cilat janë arsyet që të mos diskutohet për çështje aktive...? (z. Kastrati, bëri shpjegimet dhe arsyetimet e propozimeve të tij për anëtarët e KQZ-së).

Valdete Daka: I dëgjuam propozimet dhe shpjegimet. Çështja e policisë mund të jetë si informatë, sepse ne nuk mund ta oblicojmë policinë në agjendën e tyre. Ata, vendosin... Megjithatë, ne mund ta diskutojmë...

Mirë, i hedh në votim. Anëtarët e KQZ-së, u pajtuan që kjo pikë të diskutohet.

Çështja e dytë, ajo e zëvendëskryeshefit, është ngritur edhe në Këshill për Çështje Ligjore pra, që të shqyrtohet e gjithë baza ligjore. Mendoj që duhet të diskutohet edhe kjo pikë...

Nenad Rikallo: Çështja e zëvendës kryeshefit, është diskutuar në këshill për personel, dhe duhet të diskutohet dhe të sillet në KQZ.

Arianit Elshani: Po, në këshillë është diskutuar bashkë me çështjet që e përcjellin këtë pikë, dhe po kjo duhet të sillet edhe në KQZ...

Sami Kastrati: Pajtohem, por nuk po më kujtohet se kur është diskutuar në këshill...!

Alim Rama: Vendimi është marrë me 06.07.2019, dhe vendimi është nënshkruar nga të gjitha instancat...

Valdete Daka: Ka pasur ankesa në Komisionin e Pavarur Mbikëqyrës (KPM), dhe nga vet personi është thënë se ka ankesa në gjykata...

Eshref Vishi: Mendoj që krye shefi ishte dashur të na sjell gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe që ne ta diskutojmë. Sot, ne diskutojmë kot...

Valdete Daka: Rreth çështjes së përgatitjes së mbledhjes, për disa herë po e përsëris që agjenda përcaktohet nga kryesuesit e këshillave.

Sami Hamiti: Kërkoj nga ana juaj kryetare dhe nga krye shefi që të shihet në gjykata se, a ka ankesë, dhe nëse në këshillin gjyqësor nuk ka, kjo s'duhet të shtyhet më tej...

Valdete Daka: Në momentin që marrë informacion se nuk ka ankesë, ne s'kemi pse ta diskutojmë por vetëm duhet ta zbatojmë vendimin...

Arianit Elshani: Është mirë që të gjithë anëtarët të kenë informacion se çka ka ndodh, çka është duke ndodh mes organeve të tjera, dhe mes KQZ...

Ibrahim Selmanaj: Po e lus krye shefin që ta kemi një informatë nga gjykata, sepse kemi të drejtë të kemi informatë...

Cemajl Kurtishi: Sekretariati të na e sjellë një informatë nga instancat relevante, e do të ishte të kemi një memorandum sepse, kjo do të na ndihmonte shumë në punët tona, dhe në përgjegjësitë tona...

Ylli Buleshkaj: Unë, ka kohë që i jam drejtuar Këshillit Gjyqësorë për një përgjigje nga ata, por ju them se nuk kam arritur ende ta kem përgjigjen... Ne më herët, i jemi drejtuar edhe KPM-së por ata kanë thanë se nuk janë të obliguar të na japid informacion...

Valdete Daka: Ne, nuk kemi pse të diskutojmë mbasi nuk kemi informacion nga gjykata kompetente themelore. T'i dërgohet edhe kësaj gjykate një kërkesë dhe të shihet se ku ndodhet çështja...

Arianit Asllani: Ne, mund të diskutojmë me orë të tëra, por tash për tash s'mund të jemi më shumë të informuar...

Në fund të diskutimit, anëtarët e KQZ-së u pajtuan që ta miratojnë rendin e ditës, edhe me një pikë shtesë: atë të diskutimit lidhur me gjendjen në QNR.

Në vazhdim, u miratuan procesverbalet nga mbledhja nr. 30 dhe 31/2020, të KQZ-së.

Anëtari, Sami Kurteshi, abstenoi për shkak se, nuk i kishte në imell procesverbalet.

2. Mungesa e rojeve të policisë së Kosovës në Qendrën e Numërimit të KQZ-së

Ylli Buleshkaj u.d. i krye shefit të SKQZ, tha se praktikat janë që policia ka ofruar siguri vetëm për proceset zgjedhore, por jo edhe më pastaj. Kurse gjatë fazave jo zgjedhore, siguria në QNR bëhet nga kompani private. Ne, jemi në proces zgjedhor në Podujevë por, e kemi një informatë të policisë se, ata më tutje nuk do ta sigurojnë objektin e QNR-së. Policia, na ka ofruar një variantë që, me anë të pagesës nga KQZ, ata do ta vazhdojnë sigurinë... Kostoja e pagesës për polisinë, është trefish më e shtrenjtë se për kompanitë private. Dhe, ne nuk kemi ndarë buxhet për këtë...

Sami Kastrati: Fakt është se një paragraf i vendimit nga policia, fletë për çështjen eventuale të një marrëveshje me KQZ-në. Por unë e kundërshtoj si idenë dhe si formën për një gjë të këtillë...

Ylli Buleshkaj: Edhe një gjë: dy kontrata për një çështje të njëjtë, nuk mund t'i kemi, pastaj është edhe kostoja shumë më e lartë...

Eshref Vishi: U tha këtu edhe se kjo është çështje praktike, siguria, por çështja e policisë është çështje e sigurisë. Nëse policia ka përgjegjësi sigurinë, atëherë duhet të respektohet ligji. A është ky një rast selektiv, apo mbi çfarë baze ka veprua policia...?

Valdete Daka: Ne, e kemi vendimin e policisë dhe, ne s'mund ta ndryshojmë, me një fjalë s'mund të ndërhyjmë në punët e tyre. Aq më pak ti detyrojmë...

Eshref Vishi: Ndoshta, është mirë të ketë takim me ta, të shihen çështjet direkt me polisinë...

Nenad Rikalo: Z. Kurteshi ka të drejtë, por ne kemi nevojë që në instanca më të larta ta ngrisim këtë cështje. Policia ka rregullat e veta, por ne ta shohim nëse ky është një vendim i drejtë nga ana e tyre. Pastaj, a është kjo një praktikë e tyre, apo si...?

Sami Kurteshi: Ne, kemi një vendim nga një drejtor...!

Ylli Buleshkaj: Jo, strukturat më të larta të policisë janë të njoftuara, deri te drejtori kryesor i policisë... Por, kemi përgjigje: nëse KQZ do të bëjë marrëveshje me polisinë s'i punë sekondare e tyre me pagesë...

Valdete Daka: T'i dërgojmë një shkresë ministrit që policia të vazhdoj me sigurinë, dhe të kemi kontakte me ta...

3.Raporti i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Malishevë, Prishtinë dhe Junik:

Arianit Elshani: Në mbledhjen e fundit të Këshillit për Çështje Ligjore, bazuar në kërkesat që kanë ardhur për zëvendësimë, mbas shqyrtimit dhe analizimit të gjithë dokumentacionit të pranuar, gjykojmë që kemi proceduar në përputhje me rregullat dhe ligjin. Kërkesat, kanë kaluar nëpër filtrat e duhur dhe, nuk ka ndonjë pengesë për procedimin më tej të këtyre zëvendësimeve. Këshilli, i rekomandon KQZ-së për miratimin e këtyre zëvendësimeve:

Valdete Daka: Atëherë, kush është për që z. Shaban Bajoku të emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Podujevë, nga subjekti politik “Lidhja Demokratike e Kosovës” duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z. Benjamin Hoti ?

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime kanë miratuar këtë rekomandim.

Valdete Daka: Kush është për që z. Rabije Sallahu, të emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Kaçanik, nga subjekti politik “Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-AAK”, duke e zëvendësuar anëtaren e Kuvendit Komunal z. Afërdita Shehi ?

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime kanë miratuar këtë rekomandim.

Valdete Daka: Kush është për që z. Muhamet Selmani të emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga subjekti politik “Partia Demokratike e Kosovës-PDK”, duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z. Uran Ismaili ?

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime kanë miratuar këtë rekomandim.

Valdete Daka: Kush është për që z. Blerim Gacaferri të emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Junik, nga subjekti politik “Partia Demokratike e Kosovës-PDK”, duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z. Kreshnik Maloku ?

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime kanë miratuar këtë rekomandim.

4. Të ndryshme.